



Drejtuar prindërve dhe nxënësve

Saxon, shtator 2025

VELUX MYSTERIES

Një projekt artistik disi misterioz po përgatitet ne Saxon, dhe ne do të ishim shumë të lumtur t'ju përfshijmë në të!

Këtë vit, shoqata VELUX ju bën me dije një përvojë krijuese të quajtur VELUX MYSTERY. Kjo nismë do të shnderrojë hap pas hapi fshatin tonë në një vend të eksplorimit artistik. Shfaqje, instalacione, projeksione dhe forma të tjera origjinale do të shfaqen në vende të ndryshme përgjatë, La Nuit H. Duke nisur nisur nga 31 tetori deri në verën e vitit 2026. Këto krijime frymëzohen nga tregimet, kujtimet, ëndrrat dhe sendet, të treguar nga banorët. Nëse fëmijët janë të kujdesshëm (shih fletushkën e bashkangjitur). Ne jemi veçanërisht të interesuar të nxisim pjesëmarrjen e prindërve, kujtimet tuaja, gojëdhënat tuaja sendet tuaja janë të çmuara për ne. Ju mund të merrni pjesë duke na besuar një kujtim personal, i lidhur me një objekt. Pak rëndësi ka nëse është i vjetër, me vlerë, i thjeshtë, i harruar apo simbolik. Ajo që ne na intereson është historia që ajo mbart.

Ju gjithashtu mund të na prezantoni një histori, një ndodhi ose një kujtim familjar. E cila ka të bëjë me një ngjarje të rëndësishme, një thënie popullore të trashëguar brez pas brezi, të një historie të jetuar në Saxon ose jashtë tij, që bën fjalë për një prind, një gjysh, një hallë, një xhaxha, një komshi, ose për vetë ju.

Të gjitha dëshmitë janë të mirëpritura në gjuhën që ti preferon. Nëse ju dëshironi pjesëmarrja juaj mund të jetë anonime (pa emër).

Për të mundur të dërgoni historinë tuaj, ju mund ta dërgoni atë në adresën email në: info@vent-lumiere-saxon.ch ose mund të na dërgoni një mesazh zanor ose me shkrim në Segnal në këtë numër telefoni: 076 685 92 21

Duke marrë pjesë në këtë koleksion, ju bashkëpunoni në ruajtjen e trashëgimisë së folur dhe në krijimin e një vepre kolektive, të mbushur me ndjenja dhe plot gjallëri.

Ne mezi presim të zbulojme historitë tuaja, dhe të nxjerrim në pah bashkë me ju një dritë të re mbi misteret dhe banorët e fshatit tonë.

Me përshëndetjet tona më të përzemërta!
Stafi i kolektivit VELUX.